



Fjalor termash për COVID-19

C

COVID-19

Emri i sëmundjes së frymëmarrjes që shkaktohet nga Koronavirusi i ri (SARS-CoV-2). Gjendet edhe si «**Coronavirus Disease 2019**» – " Sëmundja e koronavirusit 2019".

D

Dhomat e presionit negativ (*Negative-pressure rooms, Θάλαμοι αρνητικής πίεσης*)

Dhomat e projektuara posaçërisht për pacientët me sëmundje infektive, në të cilat lejojnë që ajri të qarkullojë në hapësirë por pa e lejuar të qarkullojë në ambiente të tjera të spitalit.

Distancimi shoqëror (*Social distancing, Κοινωνική αποστασιοποίηση*)

Masat e marra për të rritur hapësirën fizike midis individëve dhe të ngadalësohet përhapja e një virusi. Shembuj janë teleworking, mbyllja e shkollave dhe anulimi i aktiviteteve shoqërore.

E

Epidemia (*Epidemic, Επιδημία*)

Përshkallëzimi i një sëmundjeje e cila fillon të përhapet në një zonë më të madhe gjeografike se zona e shfaqur.

G

Gjurmimi i kontakteve (*Contact tracing, Ιχνηλάτηση επαφών*)

Proçesi i identifikimit, vlerësimit dhe administrimit, të cilët kanë qenë të ekspozuar ndaj një sëmundje infektive në mënyrë që të parandalojnë përhapjen e saj të mëtejshme. Kërkohej me kë person erdhi në kontakt, atëherë izolohen edhe ata që të mos përhapet sëmundja.

I

Imuniteti i kopësë (*Herd immunity, Ανοσία της αγέλης*)

Nëse një person vaksinohet ose infektohet nga një virus, zhvillon antitrupa kundër këtij virusi. Kur një numër i mjaftueshëm individësh zhvillojnë antitrupa, atëherë popullsia në përgjithësi është e mbrojtur nga sëmundja edhe nëse nuk vaksinohet, pasi shumica janë imune dhe nuk mund të transmetojnë virusin.

Indeksi i rasteve fatale (*Case fatality rate, Δείκτης θνητότητας*)

Përqindja e vdekjeve nga një sëmundje në raport me numrin e përgjithshëm të njerëzve të diagnostikuar me sëmundjen gjatë një periudhe kohe të përcaktuar.

Indeksi i vdekshmërisë (*Mortality rate, Ρυθμός θνησιμότητας*)

Numri i vdekjeve (qoftë në përgjithësi ose për një arsye specifike) në një popullsi të veçantë, përsa i përket madhësisë së popullsisë, në njësi kohore. Si rregull njësia e matjes së vdekshmërisë është numri i vdekjeve për 1.000 njerëz në vit.

Izolimi (*Isolation, Απομόνωση*)

Kur një të sëmurë e largojmë nga të tjerët për të mos i infektuar ata. Izolimi duhet të vazhdojë derisa rreziku i infeksionit të jetë shumë i ulët, gjithmonë në konsultim me mjekun.

K

Karantina (Quarantine, Καραντίνα)

Kur një person është ekspozuar ndaj një sëmundjeje por nuk shfaq simptoma, izolohet nga të tjerët për një periudhë kohore për të parë nëse është infektuar. Mbajtja në distancë parandalon përhapjen e sëmundjes te njerëzit e tjerë. Karantina zgjat pak më shumë se nga periudha e inkubacionit të një sëmundjeje.

Koronavirusi (Coronavirus, Κορονοϊός)

Familja e viruseve që shkaktojnë një ftohje të zakonshme deri në sëmundje më serioze, të tilla si Sindromi i frymëmarrjes së Lindjes së Mesme (MERS) dhe Sindromi i rëndë i frymëmarrjes akute (SARS). Koronavirusi i ri, i zbuluar së fundmi, është quajtur SARS-CoV-2 dhe shkakton sëmundjen e frymëmarrjes COVID-19. Në mikroskop virusi duket si një sferë e rrethuar nga një kurorë, prandaj dhe përcaktimi i tij koronar (virus).

Kontakt i ngushtë (Close contact, Στενή επαφή)

Një person që mund të sëmuret nga një sëmundje ngjitëse sepse është në distancë të afërt me një një rast të konfirmuar ose i është ekspozuar ndaj tij. Në rastin e COVID-19, flasim për këdo person që gjëndet në distancë më pak se 2 metra larg nga një person që është sëmurur nga koronavirusi i ri (SARS-CoV-2) për një periudhë të zgjatur kohe ose ose ka ardhur në kontakt të drejtpërdrejtë me sekrecionet biologjike infektive të një pacienti.

N

Ndalim Qarkullimi (Lockdown, Απαγόρευση κυκλοφορίας)

Ndalimi i tubimeve dhe i lëvizjeve jo të domosdoshme me përjashtim të lëvizjeve që bëhen për për të përmbushur nevojat imediatike.

P

Pandemia (Pandemic, Πανδημία)

Përhapja e epidemisë në shumë vende dhe kontinente dhe që zakonisht prek një numër të madh njerëzish.

Periudha e inkubacionit (Incubation period, Περίοδος επώασης)

Koha nga momenti kur një person infektohet me një patogjen, p.sh. virus, derisa të shfaqen simptomat e para.



Pika lartësore e kurbes së personave të infektuar (*Outbreak, Έξαρση*)
Rritje e papritur e rasteve të personave të sëmure nga një sëmundje.

R

Rastet e konfirmuara (*Confirmed cases, Επιβεβαιωμένα κρούσματα*)
Numri i rasteve me COVID-19 të cilat janë konfirmuar me teste diagnostikuese. Për shkak të mungesës së testeve diagnostikuese, numri aktual i rasteve mund të jetë shumë më i lartë.

Rrafshimi i kurbës (*Flattening the curve, Εξομάλυνση της καμπύλης*)
Ngadalësimi i përhapjes së një virusi në mënyrë që të zvogëlohet numri maksimal i rasteve dhe kërkesa pasuese për spitale dhe infrastrukturë.

S

SARS-Cov-2

Emri i koronavirusit të ri që shkakton sëmundjen e frymëmarrjes COVID-19. Do të thotë "Severe Acute Respiratory Syndrome Coronavirus 2". Sindromi i rëndë i frymëmarrjes akute- Koronavirus 2 fillimisht i njohur si 2019-nCoV.

T

Transmetimi/ përhapja në komunitetin (*Community transmission/spread, Τοπική μετάδοση/εξάπλωση*)

Kur një sëmundje ngjitëse përhapet në një zonë gjeografike, njerëzit që janë të sëmurë nuk e dinë se ku ose si u infektuan. Është një tregues se virusi nuk kufizohet më tek një numër i vogël i individëve.

Burimet: [WHO](#), [ΕΟΔΥ](#), [CDC](#), [ECDC](#)